



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštë Upravu

-III- Nr. I prot 4066 Më 08.10.20  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opštine Orahovac / Municipal Rahovec



Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim  
Odelenje za Zastitu i Spasavanje  
Department for Protection and Rescue

## RAPORTI 9 MUJOR I PUNËS JANAR-SHTATOR 2020

---

## **Gjatë këtij 9 mujori ne si drejtori kemi pasur aktivitete si mëposhtë:**

- ❖ Gjatë 9 majorit të parë të vitit si drejtor kam qenë i angazhuar në menaxhim të kontratës për mirëmbajtjen dimërore dhe verore të rrugëve, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga komuna kemi qenë tërë kohën në terren,në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuara ndonjë problem në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorve.
- ❖ Në sektorin e zjarrfiksave në këtë 9 major kemi pasur 158 raste që kemi qenë në intervenim, pothuajse të gjitha rastet kanë qenë intervenime të lehta,vetëm një numër i vogël i tyre ishin intervenime të natyrës pak më të rëndë por që fatmirësisht nuk ka pasur viktima por vetëm ka pasur dëme materiale.
- ❖ Angazhim të rregullt në KKSBB( Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi).
- ❖ Janë inspektuar lumenjtë, përockat dhe kanalet e hapura dhe pas inqizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse për trajtim të kanaleve të bllokuara, pastrim të përockave etj.
- ❖ Është bërë servisimi i të gjitha Aparateve për shuarjen e zjarreve.
- ❖ Me vendim të kryetarit jam caktuar pjesë e shtabit emergjent komunal për menaxhimin e situatës me virusin COVID-19.
- ❖ Me ngritjen e shtabit emergjent të komunës për menaxhimin e situatës me virusin COVID-19, në njësinë e zjarrfikjes është ngritur niveli i gatishmërisë.
- ❖ Përmes drejtorisë së shëndetësisë është bërë dezinfektimi i të gjitha hapësirave në ndërtesën e zjarrfikjes dhe poashtu është bërë dhe dezinfektimi i kamionave dhe paisjeve për intervenim.
- ❖ Pas shpërthimit të zjarreve në bjeshkët e komunës sonë, saktësisht në trekufirshin Rahovec-Suharek-Malishevë, e gjithë njësia e zjarrfikjes ishte në mobilizim të brendshëm nga data 19-22 Mars, kemi qenë vazhdimisht në intervenim deri sa është arritë të shuhet plotësisht zjarri.

- ❖ Si drejtor poashtu kam qenë i angazhuar në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriqimit publik, gjatë këtij 9 mujori kemi arritë të intervenojmë në çdo vendbanim të komunës ku ka pasur probleme me ndriqim publik.
- ❖ Me vendim të kryetarit jam caktuar pjesë e komisionit për shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë, së bashku me antarët e tjerë të këtij komisioni gjatë tërë kohës së pandemisë COVID-19 kemi bërë shpërndarjen e këtyre ndihmave, ky komision vazhdon ende të jetë aktiv.
- ❖ Me datë 24 Prill një objekt banesor në qytet është përfshirë nga flaka, i gjithë stafi i zjarrfiksave është mobilizuar por që numri i tyre nuk ka qenë i mjaftueshëm për të ndalur zjarrin, është dashur të kërkohet ndihmë nga qendra emergjente rajonale në Prizren pastaj përmes tyre kemi rra në kontakt me ekipin e zjarrfiksave në Gjakovë dhe Prizren, ekipe nga këto 2 komuna menjëherë me emergjencë janë paraqitur në vend të ngjarjes dhe pastaj me ndihmën e tyre është arritur të shuhet në tërësi zjarri, menjëherë ditën e nesërme inspektori për parandalim të zjarrit ka dal në vend të ngjarjes për të vlerësuar shkaqet e shpërthimit të zjarrit dhe vlerësimi i dëmëve materiale, vlerësimi është përfunduar dhe është dorëzuar tek kryetari.
- ❖ Është bërë regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste Emergjente dhe poashtu janë bërë të gjitha përgaditjet për sezonën e nxehjtë të verës.
- ❖ Është bërë inspektimi i rregullt i objekteve publike dhe inspektimi i objekteve ekonomike dhe private në lidhje me paisjen e tyre me mjete mbrojtëse kundër zjarrit.
- ❖ Konform planit vjetor të drejtorisë kemi zhvilluar një fushatë vetëdijësuese për mbrojtje nga zjarri, nëpër të gjitha vendbanime të komunës sonë kemi shpërndarë disa fletushka që do të i ndihmojnë qytetarëve për parandalim dhe mbrojtje nga zjarri.

- ❖ Gjatë sezonës së nxeh të të vitit nuk kemi pasur numër të madh të zjarreve në fusha dhe male, përjashtimisht disa raste por që fatmirësisht i kemi kontrolluar mire.
- ❖ Kemi blerë bateri të dorës për zjarrfiksa.
- ❖ Kemi nënshkruar një kontratë të re për Servisim të Aparatave kundër Zjarrit.
- ❖ Poashtu kemi qenë të angazhuar me vërvshime që kemi pasur në komunën tonë, nuk kemi pasur ndonjë problem serioz përvetësuar disa blokime të vogla nëpër disa rrugë por që me kompanitë për intervenime emergjente kemi arritur të i pastrojmë menjëherë ato rrugë.

08.10.2020

Rahovec



Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Hasan Përboqi